

# ËSHTË KOHA PËR TË KUJTUAR - THUAJ **JO** KRIMEVE NË RRUGË



## FALENDERIM PËR PËRKRAHJE TË MARSHIT PËRKUJTIMOR DHE PROTESTUES PËR VIKTIMAT QË HUMBËN JETËN NË TRAFIK NË KOSOVË

E diela e tretë, 15 Nëntor 2015

Prishtinë

Është hera e parë që në Kosovë përgjatë gjithë javës janë zhvilluar aktivitete të ndryshme për të shënuar Ditën Botërore të përkujtimit të viktimave në trafikun rrugor.

E diela e tretë e muajit Nëntor për çdo vit shënohet anë e kënd Botës për të kujtuar miliona njerëz që humbin jetën në aksidente rrugore, por njëkohësisht edhe për të ju dhënë mbështetje familjarëve të këtyre viktimave. Në Kosovë kjo Ditë përkujtimore u shënuar me një mori aktivitete të cilat ishin një thirrje protestuese për siguri më të madhe në rrugë por edhe për të kujtuar 112 jetërat e humbura (01 Janar -15 Nëntor 2015), të qytetarëve të vendit si pasojë e aksidenteve në trafik.

Megjithatë kjo ishte një iniciativë qytetare e cila u mbështet edhe nga shoqëria civile dhe nga disa institucione të vendit, më duhet të veçojë përkrahjen e qytetarëve dhe disa prej këtyre institucioneve, të cilëve ju falënderohem sinqerisht për mbështetje dhe ndihmë të vazhdueshme. Zyra e Presidentes së Kosovës, MI, Policia e Kosovës, Komuna e Prishtinës, Kolegji Tempulli, Asociacioni Kosovar i Motorizimit-AMRKS, Forumi i Kosovës për siguri në rrugë, Transfuzioni i gjakut, Brigada e Zjarrfikësve dhe Nisma vetëdijësuese për çiklizëm.

Falënderimi i posaçëm ju dedikohet edhe atyre gazetarëve dhe medie të cilat gjatë gjithë javës përcollën aktivitetet tona dhe informuan publikun lidhur me këto aktivitete.

Në emër të grupit organizativ

Muhamed A. Krasniqi

**ËSHTË KOHA E FUNDIT PËR VEPRIM TË MENJËHERSHËM!  
STOP KRIMEVE NË RRUGË**